**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Nr.**01.400-36343 **dt.** 27.01 **2023**

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

Palët nënshkruese të marrëveshjes:

Komuna e Zveçanit
dhe
Komuna e Gllogocit

Kanë rënë dakord mbi arritjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e Buxhet, Financa dhe Administratë të Përgjithshme, Fushën e Prokurimit, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, dhe fusha tjera varësisht nga nevojat e Komunës së Zveçanit.

Duke konsideruar që bashkëpunimi në fushën e ofrimit të shërbimeve është në interes të qytetarëve të komunës së Zveçanit,

Duke pranuar që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim komunal dypalësh mbi baza të drejta.

Duke ju referuar Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, neni 17 (k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndër komunal Nr. 04/L-010, Ligji për Arbitrazhin Nr. 02/L-75.

Neni 1
BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, neni 17(k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndër komunal Nr. 04/L-010, dhe Ligji për Arbitrazhin, Nr. 02/L-75.

Neni 2

QËLLIMI

1. Qëllimi i bashkëpunimit është ofrimi i shërbimeve nga ana e Komunës se Gllogocit për nevojat e Komunës së Zveçanit.

2. Qëllimi i marrëveshjes është që të definohen qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit organ veç e veç.

3. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm.

Neni 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SECILËS PALË TË PËRFSHIRË NË MARRËVESHJE

1. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Gllogocit, ofrimi i shërbimeve si në vijim:

1.1 Buxhet, Financa dhe Administratë të Përgjithshme,
1.2 Fushën e Prokurimit,
1.3 Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Zveçanit

2.1 Komuna e Zveçanit është dhe mbetet përgjegjëse për të gjitha veprimet dhe aktet e komunës së Gllogocit, lidhur me shërbimet e ofruara nga paragrafi 1 i këtij neni.
2.2 Komuna e Zveçanit obligohet që të parashtrojë kërkesa për ofrimin e shërbimeve nga paragrafi 1 i këtij neni në kohë të arsyeshme të shoqëruara me informata të nevojshme përcjellëse.

3. Lista e shërbimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nuk është shteruese.
3.1. Me kërkesë të Komunës së Zveçanit dhe me pëlqim të komunës së Gllogocit shërbimet mund të shtohen.

Neni 4

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët në këtë marrëveshje janë pajtuar që komunikimi të zhvillohet përmes komunikimit elektronik si formë e komunikimit zyrtar e përcaktuar me legjislacioni në fuqi.

Neni 5
ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

Ç'do mosmarrëveshje mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim, arbitrazh dhe përmes gjykatës kompetente.

Neni 6
HYRJA NË FUQI

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

2. Marrëveshja është hartuar në 4 kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 2 kopje.

Komuna e Gllogocit

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLLOGOC - GLLOGOC MUNICIPALITY

Komuna e Zveçanit

Ilir Peci

Datë 27.7.2023

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Nr.** 01.400 36343 **dt.** 27 07 **2023**

UGOVOR O MEĐUOPŠTINSKOJ SARADNJI

Strane potpisnice sporazuma:

Opština Zvečan

i

Opština Glogovac

Dogovorili su se za postizanje Sporazuma o saradnji u oblasti budžeta, finansija i opšte administracije, oblasti nabavke, upravljanja ljudskim resursima i drugim oblastima u zavisnosti od potreba opštine Zvečan,

S obzirom da je saradnja u oblasti pružanja usluga u interesu građana opštine Zvečan,

Priznajući da je učešće u takvoj aktivnosti dobrovoljno i da uključuje bilateralnu opštinsku saradnju na poštenoj osnovi,

Na osnovu Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040, član 17 (k) i 30, Zakon o Međuopštinskoj saradnji br. 04/L-010, Zakon o arbitraži br. 02/L-75.

Član 1

PRAVNA OSNOVA

Bll J. P.

Ovaj sporazum o saradnji zasnovan je na Zakonu o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040, član 17(k) i 30, Zakon o Međuopštinskoj saradnji br. 04/L-010 i Zakon o arbitraži, br. 02/L-75.

Član 2
SVRHA

1. Svrha saradnje je pružanje usluga od strane opštine Glogovac za potrebe opštine Zvečan.

2. Svrha sporazuma je da jasno definiše ciljeve, namere i odgovarajuće nadlešnosti svakog tela posebno.

3. Saradnja će se realizovati na istoj osnovi reciprociteta i obostrane koristi.

Član 3
PRAVA I OBAVEZE SVAKE STRANKE UKLJUČENE U UGOVOR

1. Prava i obaveze Opštine Glogovac, je pružanje usluga kao sledeće:

1.1 Budžet, finansije i opšta administracija,
1.2 Polje nabavke,
1.3 Upravljanje ljudskim resursima.

2. Prava i obaveze opštine Zvečan

2.1 Opština Zvečan je i ostaje odgovorna za sve radnje i akte opštine Glogovac, u vezi sa uslugama koje se pružaju prema stavu 1. ovog člana.
2.2. Opština Zvečan je dužna da u razumnom roku podnese zahteve za pružanje usluga iz stava 1. ovog člana, uz neophodne naknadne informacije.

3. Spisak usluga iz stava 1. ovog člana nije konačan.
3.1. Na zahtev Opštine Zvečan i uz saglasnost Opštine Glogovac, mogu se dati dodatne usluge.

Član 4
KOORDINACIJA IZMEĐU STRANA

Strane u ovom sporazumu su se dogovorile da će se komunikacija odvijati putem elektronske komunikacije kao oblika službene komunikacije definisane važećim zakonodavstvom.

R.H. J.P.

Član 5
RASPRAVA UGOVORA

Svaki spor u vezi sa tumačenjem, upravljanjem ili izvršenjem ovog sporazuma biće rešen zajedničkim razumijevanjem, arbitražom i putem nadležnog suda.

Član 6
STUPANJE NA SNAGU

1. Ovaj sporazum stupa na snagu u trenutku potpisivanja od strane obe strane.

2. Ugovor je sastavljen u 4 originalna primerka, pri čemu strane potpisnice dobijaju po 2 primerka.

Opština Glogovac
_______________
Ramiz Lladrovci

Opština Zvečan
_______________
Ilir Peci

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY GLLOGOC

Dana 27.7.2023